



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 792 Prot.

Tiranë, më 25 /05 / 2021

**V E N D I M**

**Nr. 85, Datë 25 / 05 / 2021**

Bazuar në nenin 33, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>,

**K O N S T A T O N:**

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri, ka shqyrtuar ankesën nr.140 Regj, datë 05.11.2019, të paraqitur nga ankuesi L.Ç, kundër Bashkisë Gjirokastër dhe Agjencisë së Shërbimeve Bujqësore, veterinare dhe Mjedisore, me pretendimin për diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*”. Me vendimin nr. 43, datë 29.04.2020, Komisioneri ka disponuar në lidhje me ankesën, duke vendosur:

- *Konstatimin e diskriminimit të ankuesit L.Ç, në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Gjirokastër.*
- *Në referim të pikës 1, Bashkia Gjirokastër të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer ankuesin L.Ç në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.*

Bazuar në nenin 33, pika 11, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, përcaktohet se : “*11. Nëse komisioneri urdhëron rregullime ose masa, subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se subjekti, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, komisioneri vendos masë për ndëshikimin me gjobë për subjektin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.*”

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Bashkia Gjirokastrë, ka marrë dënim për vendimin e sipërcituar në datë 05.05.2020, fakt ky që rezultoi i provuar me anë të lajmërimi marrjes postare nr. RR 971 522 968 AA ,dhe nuk ka njoftuar Komisionerin brenda 30 ditëve, në lidhje me masat e marra për zbatimin e këtij vendimit.

Me shkresën nr.1254 prot., datë 17.09.2020, Komisioneri ka kërkuar informacion nga Bashkia Gjirokastrë, në lidhje me zbatimin e vendimit nr.43, datë 29.04.2020. Me shkresën nr.8145/1prot., datë 25.09.2020 (protokolluar pranë Komisionerit me nr.1299 prot., datë 29.09.2020), Bashkia Gjirokastrë informoi se, ka kërkuar shfuqizimin e vendimit nr.43, datë 29.04.2020, pranë Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, por nuk vendosi në dispozicion kopje të dokumentacionit provues në lidhje me këtë pretendim.

Me shkresën nr.550/2 prot., datë 01.10.2020, Komisioneri kërkoi nga Bashkia Gjirokastrë, që të depozitonte kopje të dokumentacionit provues në lidhje me pretendimin se vendimi i Komisionerit ishte bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor. Me shkresën nr.8779/1 prot., datë 07.10.2020, Bashkia Gjirokastrë informoi se, në bazë të vendimit nr.1451, datë 09.07.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Tiranë, ishte vendosur kthimi i akteve të çështjes administrative të paraqitur pranë kësaj gjykate, nga ana e Bashkisë Gjirokastrë, për kundërshtimin e vendimit nr.43, datë 29.04.2020, të Komisionerit.

Në datën 07.10.2020, pranë Komisionerit, është administruar me nr.1354 prot, dokumentacioni i dërguar nga Bashkia Gjirokastrë. Referuar këtij materiali, Bashkia Gjirokastrë vendoi në dispozicion kopje të një ankimi, sipas të cilit ajo ka kundërshtuar vendimit nr.43, datë 29.04.2020. Kopja e këtij ankimi, nuk provonte faktin që ankimi ishte depozituar pranë gjykatës.

Me shkresën nr. 9782/1 prot, datë 28.10.2020 (protokolluar pranë Komisionerit me nr.1484 prot., datë 30.10.2020), Bashkia Gjirokastrë informoi se, kishte depozituar një tjetër ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, por nuk vuri në dispozicion aktet provuese. Me shkresën nr.1429 prot. datë 21.10.2020, Komisioneri kërkoi plotësimin e dokumentacionit nga ana e Bashkisë Gjirokastrë.

Nga verifikimi i kryer nga Komisioneri, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, në lidhje me çështjet gjyqësore të ngritura nga ana e Bashkisë Gjirokastrë kundër vendimit nr.43, datë 29.04.2020, të Komisionerit, rezultoi se:

- Me vendimin nr.1451 datë 09.07.2020, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur kthimin e akteve të çështjes administrative të paraqitur pranë kësaj gjykate, nga ana e Bashkisë Gjirokastrë për kundërshtimin e vendimit nr.43, datë 29.04.2020, të Komisionerit. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datë 22.07.2020.

- Me vendimin nr.2521 datë 22.10.2020, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka disponuar në lidhje me një tjetër ankim të paraqitur nga Bashkia Gjirokastrë, duke vendosur mospranimin e padisë. Ky vendim rezulton të ketë marrë formë të prerë.
- Me vendimin nr.351 datë 21.10.2020, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, ka disponuar në lidhje me një tjetër ankim të paraqitur nga Bashkia Gjirokastrë, duke vendosur kthimin pa veprim të kërkesë padisë. Ky vendim ka marrë formë të prerë.
- Me vendimin nr.344, datë 12.10.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ka dispozuar gjithashtu në lidhje me një tjetër ankim të Bashkisë Gjirokastrë, duke vendosur shpalljen e moskompetencës dhe dërgimin e çështjes për gjykim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Me vendimin nr.533, datë 26.02.2021, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pasi ka marrë në shqyrtim çështjen e deleguar për kompetencë me vendimin nr.344, datë 12.10.2020 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ka vendosur mospranimin e kërkesës së ankuesit Bashkia Gjirokastrë. Ky vendim ka marrë formë të prerë.

Në bazë të nenit 154/a, të Kodit të Procedurës Civile, përcaktohet se : “ .....Kur paditësi nuk plotëson të metat brenda afatit të caktuar, kërkesëpadia quhet se nuk është paraqitur dhe i kthehet paditësit së bashku me aktet e tjera..... ”

Sa më sipër, rezulton plotësisht e provuar se, Bashkia Gjirokastrë, si subjekt i cili është gjetur përgjegjës për sjelljen diskriminuese, nuk ka informuar dhe nuk ka zbatuar vendimin e Komisionerit. Gjithashtu, vendimi nr.43, datë 29.04.2020, të Komisionerit, nuk rezulton të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor, pasi sa më sipër rezulton e provuar se, aknimet e paraqitura nga Bashkia Gjirokastrë kundër këtij vendimi, janë kthyer nga gjykatat për shkak të të metave, duke bërë që ato të konsiderohen se nuk janë paraqitur.

Në këtë mënyrë Bashkia Gjirokastrë, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 32/11, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Ky mosveprim, kjo mospërmbushje e këtij detyrimi ligjor, në bazë të nenit 33/13, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, shoqërohet me marrjen e masave administrative, gjobë. Për personat juridik, siç është në rastin konkret Bashkia Gjirokastrë, ky nen përcakton shprehimisht: *“Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë”:*..... b) *personi juridik nga 60.000 deri në 600.000 lekë;..... ”*

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi arrin në konkluzionin se, Bashkia Gjirokastrë, është në shkelje të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 32/11, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, shkelje e cila sipas nenit 33/13, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar është e dënueshme me gjobë.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 32/1, gërma “ç”, nenin 33, pikat 11, 12, 13, dhe nenin 33/1, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Bashkia Gjirokastrë, të gjobitet në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetëmijë) lekë.
2. Gjoba të paguhet në Buxhetin e Shtetit brenda 45 ( dyzetë e pesë) ditëve nga marrja dijani.
3. Pagesa e gjobës të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 001, Distrikti (TDO) 3535, Llogaria ekonomike: 7115499.
4. Zbatimi i vendimit nr.43, datë 29.04.2020, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, sjell shfuqizimin e gjobës.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**